



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERI PËR MBROJTJEN NGA DISKRIMINIMI

Nr. 473/1 Prot.

Tiranë, më 5 / 4 /2018

V E N D I M

Nr. 88 , Datë 5 / 4 /2018

Bazuar në nenin 32/1/a dhe nenin 33 të Ligjit nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi mori në shqyrtim ankesën Nr. 39, datë 21.07.2017, të paraqitur nga subjekti ankues O.G, si prind i fëmijës V.K, kundër Kolegjit Tiranë, në të cilën pretendohet diskriminimi i vajzës së saj për shkak të “përkatësisë prindërore”¹. Në përfundim të shqyrtimit të ankesës, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

K O N S T A T O I:

I. Parashtrimi i fakteve sipas subjektit ankues.

Sipas shpjegimeve të dhëna në ankesë, subjekti ankues deklaroi se vajza e saj, V.K ka ndjekur sistemin parashkollor të mësimin për vitin shkollor 2016-2017 në Kolegjin Gjatë zhvillimit të vitit shkollor 2016-2017, prindi i fëmijës ka kërkuar nga stafi i Kolegjit përmirësimin e metodave të mësimdhënies, fakt i konfirmuar dhe nga shkresa nr.616, datë 06.07.2017 e Drejtores së Kolegjit, drejtuar O.G, në të cilën shkruhet: “..... Në përfundim të vitit shkollor 2016-2017 keni shprehur pakënaqësinë në lidhje me metodën e punës që përdoren në Kolegj, si dhe preferencat në lidhje me personelin mësimdhënës”. Në datë 04.07.2017, O.G me anë të një kërkesë me shkrim ka kërkuar nga Kolegji që ti vihej në dispozicion një formular për regjistrimin e vajzës së saj në klasë të parë. Drejtoresha e Kolegjitme shkresën sipërcituar është përgjigjur se: “....Për shkak të performancës së Kolegjit ka pasur shumë kërkesa për regjistrime në klasën e parë. Pavarësisht infrastrukturës së Kolegjit, e kemi të sanksionuar në Rregulloren e tij, që numri i klasave për çdo vit studimi dhe numri i nxënësve për çdo klasë është i përcaktuar..... Përfundimisht, përgjigja jonë për regjistrimin e V.K në klasën e parë, pranë Kolegjit, është negative”.

¹Në formularin e ankesës, O.G ka pretenduar si shkak të sjelljes diskriminuese, përgjegjësinë prindërore, por gjatë gjithë parashtrimit të ankesës i është referuar si shkak për sjelljen diskriminuese përkatësisë prindërore, si nënë që ka kërkuar përmirësimin e metodave të mësimdhënies. Dhe në ankesën datë 19.07.2017 drejtuar Kolegjit, O.G ka identifikuar si shkak të sjelljes diskriminuese, përkatësinë prindërore.

Subjekti ankues deklaroi se shkak për mosregjistrimin e vajzës së saj në shkollë është bërë pakënaqësia që ka shprehur ajo, si prindi i fëmijës V.K në drejtim të metodave të mësimdhënies të përdorur nga personeli mësimdhënës.

Subjekti ankues, kërkon nga Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, konstatimin e diskriminimit² të vajzës së saj V.K nga ana e Kolegjit

II. Ndjekja e procedurës për shqyrtimin e ankesës nga Komisioneri.

Në nenin 1 të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, parashikohet objekti i këtij ligji, duke u sanksionuar se: *“Ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën, gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.*

Diskriminimi për shkak të përkatësisë prindërore është një formë diskriminimi e parashikuar nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” në nenin 3/4 dhe bazuar në nenin 32/1/c të ligjit, Komisioneri ka kompetencë për të shqyrtuar shkeljet që i bëhen zbatimit dhe respektimit të parimit të barazisë në lidhje me këtë shkak.

Bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 10221/2010, mbrojtja nga diskriminimi garantohet ndaj çdo veprimi ose mosveprim të autoriteteve publike ose të personave fizikë a juridikë që marrin pjesë në jetën dhe sektorët publikë ose privatë, që krijojnë baza për mohimin e barazisë ndaj një personi apo grupi personash ose që i ekspozon ata ndaj një trajtimi të padrejtë dhe jo të barabartë, kur ata ndodhen në rrethana të njëjta ose të ngjashme, në krahasim me persona të tjerë ose grupe të tjera personash.

Bazuar në nenin 33/4 të ligjit nr. 10221/2010, “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ankesa e paraqitur nga ankuesja, O.G, është e vlefshme nga pikëpamja formale pasi nuk ekziston asnjë nga rastet përjashtuese të parashikuara në këtë nen, që do ta bënte këtë ankesë të papranueshme. Si pasojë ankesa iu nënshtrua shqyrtimit të plotë.

Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, Komisioneri ka marrë në shqyrtim vetëm ato çështje, që bëjnë pjesë në kompetencat e tij, të parashikuara nga ligji nr. 10221, datë 04.02.2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Në zbatim të parashikimeve ligjore, të përcaktuara në nenet 32 dhe 33, të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi, ka shqyrtuar çështjen duke ndërmarrë hapat si më poshtë:

²Referuar procesverbalit të mbajtur në datë 14.09.2017.

- Me shkresën Nr. 716/1, datë 24.07.2017 është bërë njoftimi dhe i është kërkuar informacion subjektit, Kolegji, në lidhje me ankesën për pretendimin për diskriminim të paraqitur nga O.G.

Palët e interesuara kanë marrë dijeni për shkresën me anë të: Lajmërim marrje poste nr. RR 106 043 333 AL dhe RR 106 043 355 AL datë 25.07.2017.

Në datë 14.09.2017, ankuesja u paraqit pranë zyrave të Komisionerit dhe informoi se kërkesën për regjistrimin e vajzës së saj në shkollë, datë 04.07.2017 dhe ankesën për diskriminim drejtuar shkollës datë 19.07.2017, i ka dërguar nëpërmjet shërbimit të Postës Shqiptare, të konfirmuara me shkresat: Lajmërim marrje poste, datë 05.07.2017, nr. RR164294662AA dhe datë 21.07.2017, RR212988689AA.

Në vijim të procedurave hetimore, mbështetur në Urdhrin nr. 109, datë 19.09.2017 të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, “Për kryerjen e inspektimit në Kolegjin ..”, inspektorët e KMD-së u paraqitën pranë Kolegjit, më datë 22.09.2017, për të kryer verifikimet përkatëse mbi çështjen në fjalë.

Gjatë inspektimit pranë Kolegjit, inspektorët e KMD-s, morën takim me M.H, me detyrë, Drejtore dhe Administratore e Kolegjit dhe F.V me detyrë, Drejtor i Përgjithshëm i Kolegjit.

Gjatë inspektimit M.H informoi se: *“Si rregull 2-3 javë përpara se të përfundojë viti shkollor, lajmërojmë prindërit për regjistrimet në klasë të parë, por O.G nuk është lajmëruar sepse kishte deklaruar se nuk do sillte vajzën në klasë të parë, sepse nuk pëlqente mësuën (pa arsye) e klasës së parë (B.Dh) dhe kurrikulën e veçantë të Kolegjit. Si drejtuese e institucionit ka qenë shumë e kënaqur me sjelljen dhe performancën e fëmijës, por që nga periudha, Janar-Qershor 2017, prindi i fëmijës ka shkelur rregulloren e shkollës, ka shpifur gjëra të pa qena për drejtuesen e institucionit dhe stafin mësimdhënës e ndihmës”.*

Gjatë inspektimit F.V, informoi se: *“Në lidhje me shkresën e drejtuar nga O.G në datë 19.07.2017, nuk është kthyer përgjigje, sepse nuk e kemi detyrim ligjor për të kthyer përgjigje, pasi nga O.G ishte refuzuar dhe takimi i datës 10.07.2017. Periudha e regjistrimit dhe numri i nxënësve për klasë janë të parashikuara në rregulloren e brendshme të Kolegjit, Kreu I, pika 8 dhe neni 13/1 i Dispozitave Normative. Regjistrimi i fëmijëve në klasë të parë është bërë në periudhën e fundit të muajit Qershor 2017 në mënyrë verbale me telefon ose me gojë ndërsa regjistrimi zyrtar është kryer në muajin Shtator, në momentin kur kryhet pagesa e parashikuar në kontratë. Në vitin shkollor 2016-2017, klasa e parashkollorit është frekuentuar nga 6 fëmijë, 4 nga të cilët janë regjistruar në klasë të parë”.*

Gjatë këtij inspektimi M.H, parashitroi këto pretendime: *“Kërkoj një ballafaqim mes gjithë pjesëtarëve të familjes të nxënëses V.K me stafin drejtues të shkollës për pretendimet e ngritura nga O.G. Mes të tjerash disponon dhe video-audio për një takim që është bërë në zyrën e M.H. Në këtë takim nëse është e mundur të thirret dhe prindi E.J, (një nxënës i grupit) për të cilin O.G më ka deklaruar si burim thashethemi ndaj meje”.*

Nga verifikimi i kryer në formularët e regjistrimit të nxënësve në klasë të parë, rezulton se: 7 nxënës³ kanë dorëzuar formularin e regjistrimit apo kanë konfirmuar përpara datës 06.07.2017, ndërsa 14⁴ nxënës kanë dorëzuar formularin e regjistrimit nga data 13.07.2017 deri më datë 31.09.2017 dhe formulari për një nxënës⁵ është pa datë.

Nga verifikimi i kryer në Rregulloren e Brendshme të Kolegjit, datë 20.09.2016, Kreu Parë, pika 8, përcaktohet se: Numri maksimal i nxënësve në klasë do të jetë 20-24 nxënës, ndërsa në Kontratën tip të Kolegjit, pika 3.1, përcaktohet se: Numër i kufizuar nxënësish në klasë (jo më shumë se 20).

Më datë 13.10.2017 në mjediset e zyrës së Komisionerit u zhvillua një seancë dëgjimore mes palëve. Në këtë seancë morën pjesë, F.V, me detyrë Drejtor i Kolegjit, N.K, Kryetar i Komitetit të Prindërve, M.T me detyrë Kryetare e Bordit të Kolegjit, A.B, me detyrë nëndrejtores për ciklin parashkollor dhe fillor të Kolegjit, E.C me detyrë edukatore dhe subjekti ankues O.G.

Bazuar në nenin 80/1/b të Kodit të Procedurave Administrative dhe Rregullosës së Brendshme të Komisionerit, seanca dëgjimore u regjistrua audio dhe përmbajtja e saj do të përdoret si provë gjatë procesit të shqyrtimit të ankesës.

III. Në përfundim të procedurave të shqyrtimit të ankesës dhe bazuar në dokumentacionin e administruar, Komisioneri vëren se:

A. Lidhur me pretendimin e ankueses se vajza e saj është trajtuar ndryshe nga Kolegji, përmes mos regjistrimit të vajzës së saj në shkollë.

Në nenin 32/2 të ligjit nr. 69, datë 21.06.2012 “Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë”, përcaktohet se: *“Institucioni arsimor funksionon sipas rregullores së tij të brendshme, e cila është në përputhje me këtë ligj e aktet e tjera ligjore në fuqi dhe miratohet nga titullari i njësisë arsimore vendore përkatëse”.*

Veprimtaria e brendshme e Kolegjit rregullohet nëpërmjet legjislacionit për arsimin parauniversitar dhe Rregullosës së Brendshme të Kolegjit të datës 20.09.2016. Në germen A, të Kreut të Nëntë, të kësaj rregulloreje përcaktohet se për regjistrimin në klasën e parë, duhet të paraqesin këto dokumente: çertifikatë personale me fotografi..... – çertifikatë vaksinimi..... – raport nga okulisti. – vërtetim vendbanimi, dhe vërtetim nga drejtorja e kopshtit. Pra nga sa vërehet nga rregullorja e brendshme dhe nga dokumentacionet e publikuara online nga Kolegji, vërtetohet se nuk ka procedura të shpallura dhe transparente se si rregullohet procesi i regjistrimit të nxënësve në klasë të parë. Ndërkohë gjatë inspektimit të zhvilluar në datë 22.09.2017, dhe nga deklaratimet e bëra gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore në datë 13.10.2017, nga ana e drejtuesve të Kolegjit është deklaruar se procedura e regjistrimeve për nxënësit e klasës së parë fillon rreth 2-3 javë përpara se të përfundojë viti shkollor, pra në muajin Qershor, dhe prindërit lajmërohen

³Nxënësit: E.T, K.K, F.K, D.V, E.H, R.Q, H.Z

⁴Nxënësit: G.C, A.D, V.SH, A.F, A.M, D.SH, F.T, N.L, A.D, L.M, N.Q, A.M, L.LL, A.A.

⁵ Nxënësi: A.Xh

në mënyrë verbale me telefon dhe i dërgohet një njoftim me shkrim, nëse duan që fëmijët e tyre të ndjekin klasën e parë pranë Kolegjit.

Ankuesja referuar dokumentacionit të dorëzuar pranë Komisionerit ka vërtetuar se, në datë 04.07.2017, me anë të një kërkesë me shkrim ka kërkuar nga Kolegji që ti vihej në dispozicion një formular për regjistrimin e vajzës së saj në klasë të parë.

Referuar shkresës nr.616, datë 06.07.2017 të Drejtores së Kolegjit, drejtuar O.G, vërehet se drejtuesja e Kolegjit në përgjigje të kërkesës për të regjistruar nxënësen në klasë të parë, informon prindin se për shkak të kërkesave të shumta dhe numrit të kufizuar të nxënësve për klasë nuk mund të regjistrojë vajzën në klasë të parë për shkak se janë mbyllur regjistrimet.

Referuar formularëve të regjistrimit të nxënësve në klasë të parë të Kolegjit, vërtetohet se 7 nxënës kanë dorëzuar formularin e regjistrimit apo kanë konfirmuar për tu regjistruar në shkollë përpara datës 06.07.2017, ndërsa 14 nxënës kanë dorëzuar formularin e regjistrimit nga data 13.07.2017 deri më datë 31.09.2017 dhe një nxënës nuk ka datë në formular. Gjithashtu, në seancën dëgjimore⁶ përfaqësuesi i Kolegjit, F.V duke argumentuar plotësimin e numrit të nxënësve për klasë në datë 06.07.2017, pohoi se numri i nxënësve për klasë duhet të jetë 20, por kanë pranuar regjistrime për 24 nxënës nga të cilët dy nxënës janë tërhequr dhe janë regjistruar dhe vazhdojnë shkollën 22 nxënës, në tejkallim të numrit të parashikuar, dhe për kalimin e numrit të nxënësve për klasë shpjegoi se do merrnin përsipër të justifikoheshin në MAS, referuar pohimeve të bëra para Komisionerit, të regjistruara audio.

Në vlerësim të dokumenteve të administruara mbi procedurat e përdorura nga Kolegji në lidhje me regjistrimin e nxënësve në klasë të parë, Komisioneri konstaton se Kolegji ka pranuar dhe regjistruar nxënës në klasë të parë deri në një periudhë më shumë se dy muaj pas datës 06.07.2017, datë kur është bërë kërkesa nga O.G për regjistrimin e vajzës së saj në klasë të parë.

Për sa më lart, Komisioneri vlerëson se mosregjistrimi i vajzës së O.G në klasë, me pretendimin se është plotësuar numri i nxënësve ka vendosur vajzën e O.G në pozita të pabarabarta, duke mos i dhënë mundësinë për tu regjistruar dhe vazhduar shkollën pranë Kolegjit në të cilin kishte kryer dhe arsimin parashkollor.

B. Lidhur me shkakun e pretenduar nga ankuesja (përkatësisë prindërore) si shkak të sjelljes diskriminuese ndaj vajzës së saj.

Për të vërtetuar se ndaj ankueses ka një sjellje diskriminuese nga ana e Kolegjit, duhet të ekzistojë një lidhje shkakësore ndërmjet shkakut të mbrojtur nga ligji 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”⁷ dhe trajtimin të pafavorshëm të ankueses.

⁶Minuta 55.22 të regjistrimit të seancës dëgjimore.

⁷ Në interpretim të nenin 1, të ligjit “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, “...ky ligj rregullon zbatimin dhe respektimin e parimit të barazisë në lidhje me gjininë, racën, ngjyrën, etninë, gjuhën, identitetin gjinor, orientimin seksual, bindjet politike, fetare ose filozofike, gjendjen ekonomike, arsimore ose shoqërore, shtatzaninë, përkatësinë prindërore, përgjegjësinë prindërore, moshën,

Pretendimi i O.G se shkak për diskriminimin ndaj vajzës së saj është përkatësia prindërore, pasi ajo si prind është ankuar ndaj stafit të shkollës për metodat e mësimdhënies, përbën një shkak që gëzon mbrojtje sipas nenit 1 të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”.

Nga shqyrtimi i dokumenteve⁸ të administruara nga Komisioneri, rezulton se Kolegji ishte në dijeni të pakënaqësive të shprehura nga O.G në drejtim të metodave të punës që përdorshin në Kolegj dhe pakënaqësisë për mësuesen e klasës së parë.

C. Lidhja e veprimit të Kolegjit, me shkakun e pretenduar nga subjekti ankues.

Referuar shkresës nr.616, datë 06.07.2017, të Kolegjit, drejtuar O.G, në të cilën drejtuesit e Kolegjit pretendojnë se mosregjistrimi i nxënësës V.K në Kolegj ka ardhur si rezultat i zbatimit të rregullores së Kolegjit në lidhje me respektimin e numrit maksimal të nxënësve për klasë dhe se në datën kur është kërkuar për të regjistruar vajzën e O.G ishte plotësuar numri i nxënësve për klasë, konstatojmë se: - Në dokumente të ndryshme të Kolegjit, si Rregullorja e Brendshme e Kolegjit (e administruar gjatë inspektimit datë 22.09.2017), Rregullore e Brendshme e Kolegjit (e publikuar online⁹ në datë 08.11.2017), Kontrata tip dhe deklaratës së F.V, konstatohet se nuk kemi një shifër të saktë për numrin e nxënësve në klasë, pasi ky numër varion nga 20 në 24 nxënës për klasë, dhe se në datë 06.07.2017 ka pasur vetëm 7 nxënës që kishin dorëzuar formularin e regjistrimit apo kishin konfirmuar për tu regjistruar në klasë të parë.

Gjithashtu, drejtuesit e Kolegjit deklaruan se, O.G është lajmëruar me shkresë, nëse dëshironte të regjistronte fëmijën në klasë të parë, por që nuk kishin marrë përgjigje nga O.G brenda muajit Qershor, nuk rezulton e saktë pasi referuar deklaratës së M.H¹⁰, O.G nuk është lajmëruar për regjistrimin e fëmijës pasi kishte deklaruar se nuk do të sillte vajzën në klasë të parë.

Për të justifikuar veprimin e mospranimit për regjistrimin e nxënësës V.K, Kolegji parashtroi si argument përpara Komisionerit faktin se në datë 10.07.2017 ishin shkëmbyer mesazhe të shkruara telefonike mes Kolegjit dhe O.G në lidhje me organizimin e një takimi mes drejtueses së Kolegjit dhe O.G në të cilin pretendohet se do vazhdonin bisedat mbi regjistrimin e nxënësës V.K në shkollë, takim i cili nuk është zhvilluar pasi kërkuesja e takimit, O.G i ka kthyer përgjigje mesazhit¹¹ duke informuar se nuk do paraqitej në takim pasi ishte njoftuar me shkrim për vendimin e Kolegjit dhe se do i drejtohej me ankesë institucioneve të tjera në lidhje me mosregjistrimin në shkollë të vajzës së saj.

Më shkresën, Ankesë datë 19.07.2017, drejtuar me e-mail, Kolegjit, O.G është ankuar dhe është shprehur se si ka mundësi që të gjithë fëmijët e grupit të vajzës së saj janë regjistruar dhe vajza e saj nuk është regjistruar. Gjithashtu, ankuesja i ka bërë me dije Kolegjit se fëmija i saj po

gjendjen familjare ose martesore, gjendjen civile, vendbanimin, gjendjen shëndetësore, predispozicione gjenetike, aftësinë e kufizuar, përkatësinë në një grup të veçantë, ose me çdo shkak tjetër”.

⁸ Shkresa nr.616, datë 06.07.2017 e Kolegjit. Procesverbali i mbledhje së bordit të kolegjit.

⁹ Referuar Rregullores së Brendshme të Kolegjit Viti Shkollor 2014-2015, datë 05.09.2014, të publikuar në faqen e internetit të shkollës: www.theindependent.edu.al/cambridge-international-examinations/rregullore/

¹⁰ Referuar procesverbalit të inspektimit, datë 22.09.2017.

¹¹ Referuar dokumentacionit të administruar gjatë inspektimit datë 22.09.2017 dhe seancës dëgjimore datë 13.10.2017.

diskriminohet për shkak të pakënaqësive që ka shprehur ajo si nënë në drejtim të metodave të punës që përdor personeli mësimdhënës i Kolegjit.

Kolegji nuk i ka kthyer asnjë përgjigje ankueses që do të ndihmonte në zgjidhjen dhe sqarimin situatës por e ka trajtuar çështjen sikur institucioni nuk ka detyrim ligjor për të kthyer përgjigje¹² ndaj një ankese për diskriminim.

Në ligjin 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi” neni 3/8, përcaktohet se: “*Viktimizimi*” është trajtim i disfavorshëm apo pasojë negative, që vjen si reagim ndaj një ankimi a një procedimi që synon zbatimin e parimit të barazisë”.

Në ligjin nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, neni 5, Ndalimi i diskriminimit, pika 1, parashikohet: “*Ndalohet diskriminimi për shkaqet e përmendura në nenin 1 të këtij ligji dhe mosmarrja në shqyrtim, sipas rasteve të përmendura në nenin 3 të këtij ligji, e një ankimi ase procedure, si dhe çdo formë tjetër sjelljeje që pengon zbatimin e parimit të trajtimit të barabartë*”.

Në nenin 19/ç të ligjit nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Detyrat e drejtuesit të institucionit arsimor, parashikohet: “*Drejtuksi i institucionit arsimor është përgjegjës për marrjen e masave me karakter pozitiv në institucionin përkatës, për të luftuar diskriminimin në lidhje me të drejtën për arsimim. Masat që merren, ndër të tjera, janë: ç) trajtimi efektiv i ankesave për diskriminim në institucion, duke shqyrtuar çdo ankim brenda 30 ditëve nga paraqitja e tij*”, në këtë kontekst, Kolegji ka dështuar në zbatimin detyrimit ligjor për ti kthyer përgjigje pretendimeve të O.G.

Komisioneri konstaton se ndjekja e një të drejte ligjore¹³ që ka prindi për të diskutuar dhe kërkuar përmirësimin e mësimdhënies, nuk përbën ndonjë shkelje apo cënim të ndonjë të drejte apo imazhit të institucionit arsimor.

Për sa më lart, Komisioneri konstaton se përveç trajtimit të pabarabartë të fëmijës V.K, Kolegji në asnjë moment nuk ka marrë në konsideratë pasojat psikologjike që mund ti shkaktosheshin asaj nga ndarja me shokët dhe shoqet e klasës.

Ligji nr. 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, ndalon diskriminimin që bazohet në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji, pra edhe për shkak të përkatësisë prindërore dhe që ka si qëllim apo pasojë pengesën apo bërjen e pamundur të ushtrimit në të njëjtën mënyrë me të tjerët, të të drejtave e lirive themelore të njohura me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, me aktet ndërkombëtare të ratifikuara nga Republika e Shqipërisë, si dhe me ligjet në fuqi.

¹² Referuar deklaratës së F.V gjatë inspektimit datë 22.09.2017.

¹³ Neni 6/8 të ligjit 69/2012 “Për sistemin arsimor parauniversitar”: Në sistemin arsimor parauniversitar garantohet e drejta e nxënësve, e punonjësve arsimorë, e prindërve dhe përfaqësuesve të tyre ligjorë, për të shprehur pikëpamjet e tyre për cilësinë e shërbimit arsimor dhe për t’u dëgjuar për këto pikëpamje.

Ligji 10221/2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi”, në nenin 3, pika 2, parashikon se: *“Diskriminimi i drejtpërdrejtë” është ajo formë diskriminimi që ndodh kur një person apo grup personash trajtohen në mënyrë më pak të favorshme sesa një person tjetër, apo një grup tjetër personash në një situatë të ngjashme, bazuar në cilindo shkak të përmendur në nenin 1 të këtij ligji”.*

Në këtë kontekst, referuar nenit 17/1/ç të ligjit 10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, nga analizimi në tërësi i fakteve të sipërpërmendura, vlerësohet se fëmija V.K, është ekspozuar ndaj një trajtimi të padrejtë dhe diskriminues, nga ana e Kolegjit, për shkak të përkatësisë prindërore, duke u diskriminuar për shkak të pakënaqësive të shprehura nga O.G në drejtim të metodave të punës që përdoren në Kolegj.

PËR KËTO ARSYE:

Mbështetur në nenet: 3/8, 5/1, 17/1/ç, 19/ç, nenin 21/1, nenin 32/1/a dhe pika 2, si dhe nenin 33, pikat 1, 3, 5, 7, 10 dhe 11 të Ligjit nr.10221/2010 “Për Mbrojtjen nga Diskriminimi”, Komisioneri për Mbrojtjen nga Diskriminimi,

V E N D O S I:

1. Konstatimin e diskriminimit të drejtpërdrejtë, të shtetases V.K, nga ana e Kolegjit, për shkak të përkatësisë prindërore, në fushën e arsimit.
2. Konstatimin e viktimizimit, të shtetases V.K, nga ana e Kolegjit.....
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, brenda afateve ligjore.

Irma BARAKU

KOMISIONERI

(shkaku: perkatesia prinderore)
(fusha: arsim)